



Pranuar / Dorezuar Primiçeno / Prodatë Received / Delivery	26. 12. 8	viti god year	
Organ / Njësia Org. / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHCK	7984/2018		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOV

Anr. 714/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani- kryetar, Lela Petkovic dhe Malsore Gashi- anëtar, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr.714/2018, të datës 05.11.2018, së ankuesja Gjylaj Shipkovic, numër, nga Komuna e Prizrenit, kundër organit të punësimit Komuna e Prizrenit, në çështjen juridike “ kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 24.12.2018, mori këtë

V E N D I M

I. HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa A. Nr.714/2018, e datës 05.11.2018, e parashtruar nga ankuesja Gjylaj Shipkovic.

A r s y e t i m

Komuna e Prizrenit, me datë 25.07.2018, ka pranuar autorizimin për shpalljen e konkursit për pozitën „Drejtor i SHML „Gjon Buzuku”, në Prizren në Komuna e Prizrenit, nga Ministria e Administratës Publike/ Departamenti për Shërbimin Civil.

Komuna e Prizrenit, me datë 25.07.2018, ka shpallur konkursin për pozitën „Drejtor i SHML „Gjon Buzuku”, në Komunën e Prizrenit. Ankuesja Gjylaj Shipkovic, me datën 10.10.2018, me ankesë i është drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave tek Komuna e Prizrenit.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Prizrenit, me datë 22.10.2018, me numër protokolli 02-111/151982, ka nxjerr vendim me të cilën e aprovuar ankesën e ankueses si të bazuar në ligj duke e anuluar procedurën e rekrutimit për pozitën Drejtor i SHML „Gjon Buzuku’.

Ankuesja Gjylaj Shipkovic, pasi ka pranuar vendimin me numër protokolli 02-111/151982, të datës 22.10.2018, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prizrenit, me datën 02.11.2018 me numër protokolli 6536/2018, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për mes e- mailit zyrtar për ankesa ka parashtruar ankesë me pretendimet

ankimore se procedurat e rekrutimit për pozitën ‘‘ Drejtor i SHML ‘‘Gjon Buzuku’’, në Komunën e Prizrenit është bërë në kundërshtim me Ligjin për Shërbimin Civil dhe aktet nënligjore në fuqi, nga Komuna e Prizrenit.


Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 02.11.2018 A nr. 714/2018, me numër protokolli 6536/2018, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 22.10.2018, me numër protokolli 02-111/151982, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; ‘‘Formuari E’’, Ankesa e datës 10.10.2018, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave Konkursi i datës 25.07.2018.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesi Gjylaj Shipkovic , **është e palejuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtim e ankesave ka konstatuar se në bazë të raportit me rekomandim të kolegjit për Vëzhgim, Këshilli me vendimin 377/2018 të datës 05.12.2018, ka aprovuar zhvillimin e procedurave të rekrutimit, për pozitën ‘‘ Drejtor i SHML ‘‘Gjon Buzuku’’, në Komunën e Prizrenit, me arsyetimin se procedurat e rekrutimit janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e Ligjit Nr. 03/ L – 149 për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, .

Kolegji për shqyrtim e ankesave, ka konstatuar se pala e pakënaqur kundër vendimit të Këshillit, në rastin e nxjerrjes së vendimit, të nivelit drejtues, duhet të veprojë në pajtim me nenin 19, paragrafi 8, Ligji nr. 06/1 -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se; **8. Vendimi i Këshillit për procedurën e përzgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, është vendim përfundimtar në procedurë administrative dhe kundër këtij vendimi palët në procedurë kanë të drejtë të iniciojnë konflikt administrativ, në pajtim me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ’’. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se palët e pakënaqur me vendimin e Këshillit për nivelin drejtues, mund të paraqesin padi konflikt administrativë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.**

Andaj bazuar në këto rrethana Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr. 714/2018,

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Vendimi i dërgohet:

- **Ankueses Gjylaj Shipkovicë ;**
- **Kryetarit të Komuna e Prizrenit;**
- **Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prizrenit;**
- **Arkivit të KPMSHCK-së**